



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 21/2008

Më 14.10.2008, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Salla C-202

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani, Et'hem Çeku, Haki Shatri, Kaqusha Jashari, Fatmir Rexhepi, Safete Hadergjonaj, Zef Morina dhe Sala Berisha – Shala.

Munguan: Slobodan Petroviq, Berim Ramosaj dhe Mufëra Şinik.

Të pranishëm: Gani Koci - kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Xhevdet Smakiqi - këshilltar i ministrit të MTPT, Krenare Sfishta – Departamenti Ligjor në MTI, Izer Arifi - Departamenti i Turizmit në MTI, Hysen Sogojeva - shef i Divizionit të Hotelërisë në MTI, Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi nga USAID-i, dhe Blerina Uka nga NDI-i;

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Nuriye Morina;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së kaluar të 2 tetorit 2008;
3. Shqyrtimi i Ligjit: a) për shpronësim; b) për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rrugët nr. 2003/11 dhe c) për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrik 2008);
4. Miratimi në parim i Projektligjit për Masat Antidamping;
5. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të datës 2 tetor 2008;

Procesverbali i mbledhjes së 2 tetorit 2008, u miratua më vërejtjet e deputetës Safete Hadergjonaj, të cilat do të inkorporohen në atë procesverbal (02.10.2008).

III. Shqyrtimi i Ligjit: a) nr. 02/L-97 për shpronësim; b) nr. 02/L-35 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rrugët nr. 2003/11 dhe c) nr. 03/L-027 për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);

III/a) Ligji nr. 02/L-97 për shpronësim (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);

Kryetarja – i'a dha fjalën z. Haxhi Gashi nga USAID, për t'i paraqitur vërejtjet e tij.

Haxhi Gashi (USAID-i) – duke elaboruar takimin e fundit, për ti shqyrtuar vërejtjet e Ministrisë së Transportit, për këtë Ligj, lidhur me ndryshimin e afateve të shpronësimit. Duke shtuar më tej së në bazë të konsultimeve, që i ka pasur me ekspertë të fushës së tij, ai theksoi se është nevoja me i zgjatë afatet për shkak se edhe vendet tjera kanë afate më të gjata mirëpo janë edhe disa probleme pronësore lidhur me pronat dhe kthimit të drejtës së pronësisë siç parashihet sipas Ligjit dhe nenit 14, dhe njiherit kërkoj që fjala ti kaloj z.Bill Klawonn (USAID), i cili ka njohuri me ekspertë të fushës së shpronësimit.

Bill Klawonn (USAID) – duke falënderuar për dhënien e fjalës theksoj se në bazë të Kushtetutës, pikërisht nenit 46, në bazë të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe në bazë të praktikave të Bankës Botërore, ky Ligj në gjendjen e tanishme nuk i plotëson kushtët për miratim, sepse shkakton konfuzion në procesin e shpronësimit. Në fund i premtoj Komisionit së të gjitha amendamentet do ti sjell më shkrim.

Gani Koci (kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa) - sipas projektligjit për Shpronësim, një drejtë e pronës i merret pronarit pasiqe të ndodhe kompensimi, e filloj diskutimin z.Koci. Duke vazhduar të neni 14, ku tha se mund të ketë dilema dhe zbrazeti por megjithatë ka dy ose tri momente se kur mund të me u revokuar procesi i shpronësimit, dhe këto i përcakton Ligji shume qartë, duke u bazuar tek një shembull të shpronësimit, që nga vitet e 90-ta, dhe akoma nuk është zbatuar procedura në atë pronë. Duke referuar në atë se ky shembull tregon qartë se sot mund të jetë interes publik ndersa nesër jo.

Et'hem Çeku - ishte i mendimit se ky Ligj duhet të harmonizohet me ministrinë që i tangon posaqërisht me ministrin e Minierave dhe Energjetikës. Duke e ditur se tani kemi zhvillime shumë të shpejta dinamike të sektorit të energjisë, dhe po ashtu lufta e madhe financiare që është duke ndodh duhet ti kemi parasysht afatet kohore, dhe poashtu e mbështeti ide që ky Ligj është kthyer, mirëpo shfaq brengën për mos harmonizimin me ligje të tjera.

Bill Klawonn (USAID) – shprehu përkrahjen e tij dhe propozoj që është me rëndësi që në këtë Ligj duhet që të përfshihen edhe këshilltarët e Bankës Botërore.

Gani Koci (kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa) – theksoj se vendi ynë ka mjaft ekspert të kësaj fushe, dhe nuk duhet të anashkalohen por të ftohen edhe ata, në mënyrë që të japin kontributin e tyre dhe krejt në fund shtoj se nuk hjek dorë nga propozimi i tij për nenin 14.

Safete Hadergjonaj – theksoj se nuk e përkrah idenë që perseri të shtyhet ky diskutim për këtë çështje pasi që edhe javën e kaluar është shty dhe nuk është punuar asgjë në këtë drejtim, duke marr parasysh rëndësinë e këtij Ligji. Dhe propozoj që të formohet një grup punues për shqyrtimin e këtij Ligji.

Xhevdet Smakiqi - këshilltar i ministrit të MTPT-së – tha se Ministria e Transportit nuk ka qenë sponzoruese e këtij Ligji, dhe amendamentet që ka sjell ministria janë vetëm për dis çështje mirëpo z. Bill, e prekur konceptin e Ligjit dmth shumë çështje esenciale që mundën me marrë shumë kohë dhe poashtu u pajtua që të shtyhet edhe për dy jave. Në fund tha se qëndrojmë vetëm mbas amendamenteve që i kanë propozuar dhe kërkojnë që sa më shpejtë të aprovohet ky Ligj se duhet me ja përshtat më shumë realitetit kosovar sepse kemi pasur jashtëzakonisht ndryshime të mëdha politike edhe ekonomike.

Pas diskutimit të gjerë, Komisioni unanimisht nxorri këtë:

Përfundim

- a) Shtyhet - vazhdohet rishqyrtimi i Ligjit për shpronësim, me qëllim të mbledhjes së informatave;
- b) Autorizohen të interesuarit që brenda afatit të propozojnë dhe të arsyetojnë amendamente përkatëse;
- c) Caktohet Grupi punues në këtë përberje: Myzejene Selmani, Et'hem Çeku, Safete Hadergjonaj, Haki Shatri dhe Zef Morina;

III/b) Ligji nr. 02/L-135 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11 (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);

Kryetarja – e hapi diskutimin edhe për këtë nënpikë të rendit të ditës dhe kërkoi komente të anëtarve të Komisionit.

Zef Morina – propozoj që të kalohet nen për nen dhe të miratohen në këtë mbledhje. Mirëpo pastaj shtoj se vërejtjet e tij janë tek kategorizimi i rrugëve dhe tek brezi rrugor sepse në këtë Ligj është bërë një llojë përzirje e kësaj çështje, dhe kërkoj nga Ministria që të dërgojë një detal, se a ka bërë ndonjë ndryshim nga ligji i vjetër apo është ligji i njejtë në mënyrë që ta dinë anëtarët e komisionit. Vërejtja tjetër është tek rrugët publike, duke e ditur se rrugë publike janë të gjitha rrugët duke e përfshirë edhe rrugët magjistrale edhe

rrugët tjera por ato nuk duhet të jenë kompetenca e komunave, ato duhet të jetë kompetenc e ministrisë këto d.m.th është bërë një ndryshim kategorizohet, se është një term i përgjithëshëm për komuna të cilat nuk kanë me qenë në gjendje me bartë barrën e mirëmbajtës që e kanë ndaj saj. Pastaj propozoj që rrugët magjistrale të quhen rrugë nacionale, por edhe regjionale, sepse ne e kemi regjionin dhe nuk mundemi me i ndal ato sepse është dhenë edhe arsyeja se për çka duhet të thirren ashtu rrugë regjionale, dhe kishte me qenë më mirë me mbetë, nëse të gjithë pajtoheni për rrugët të cilat e lidhin Kosovën me vende të tjera, përfundoj z.Morina.

Kaqusha Jashari – në diskutimin e saj tha se propozimet në tërësi janë të mira por duhen edhe disa sqarime. Duke filluar elaborimin më tej tek neni 1 të dispozitat e përgjithëshme, tha se janë në rregull mirëpo radhitja duhet me pas kujdes, dhe se mungon ajo çka është rrugë lokale, çka rrugë urbane etj. Poashtu u pajtua me z.Morina, lidhur me rrugët magjistrale. Pastaj tek neni 8 duhet një skjarim më gjeneral e më i qart dhe propozoj që duhet të konsultohet edhe zyra e Bankës Botërore, sepse deri më tani kanë qenë donatorët më të rëndësishëm, dhe do jenë edhe për autoudhë. Në fund tha se unë këto amendamente do ti prezentoj në Grupin punues më gjithë arsyetimet.

Safete Hadërgjonaj - u pajtua me mendimin e znj.Jashari, dhe ishte e mendimit se Grupi punues, ti sjell të gjitha mendimet apo vërejtjet në Komisionit, dhe pastaj të shiqohen nëse ka ne to ndryshime që të plotësohen të gjitha në takimin e ardhëshëm.

Haki Shatri – nuk ishte i pajtimit më propozimin e Ministrisë për nenin 4, që është propozimi për një nen të ri ku duhet të përputhet mirëmbajtja e jashtëzakonshme, dhe kriteret që Ministria duhet ti përmbaj si është shkruajtur në Ligj. Dhe premtoj se do ti sjell më shkrim propozimet e tij Grupit punues.

Pas diskutimeve të gjëra, Komisioni unanimisht e nxori këtë:

Përfundim

a) Shtyhet - vazhdohet rishqyrtimi i Ligjit për rrugët nr. 2003/ 11, me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të ekspertizës së disa fakteve dhe harmonizimit të qëndrimeve në mes të Ministrisë së Transportit dhe Komisionit për riamendamentimin e Ligjit;

III/c) Ligji nr. 03/L-027 për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike (sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03/0859/498-4 të 20 korrikut 2008);

Kryetarja – ia dha fjalën z.Haki Shatri, si referues për këtë Ligj, për t'i paraqitur vërejtjet e tij.

Haki Shatri – i pranoj vërjetjet e Mininstrisë për nenin 5 ndërsa për nenin 8 më ndryshimin që ti shtohet edhe fjalia që përfshinë edhe “organin kompetent”. Poashtu edhe të neni 3.4 shtohet fjalia “paguhen menjëhere” dhe fjalet sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr.03/L-048, të vitit 2008.

Pas diskutimeve të gjëra, Komisioni uanimsisht e nxori këtë:

Përfundim

- a) Miratohen amendamentet e Ligjit nr. 03/L-027 për Taksën e akomodimit në objektet hoteliere e turistike;
- c) Autorizohet administrata që ta përgatis Raportin më Rekomandime për seancë në afat sa më të shpejtë;

IV. Miratimi në parim i Projektligjit për Masat Antidamping;

Kryetarja – i njoftoi anëtarët e Komisionit për arritjen e Projektligjit për Masat Antidamping, dhe kërkoj opinionet e tyre për miratimin në parim.

Pas diskutimeve të gjëra, Komisioni uanimsisht e nxori këtë:

Përfundim

- a) Miratohet në parim Projektligji për Masat Antidamping;
- b) Autorizohet kryetarja e Komisionit si Raportuese e Komisionit në seancë;

V. Të ndryshme;

V.a) Shqyrtimi i propozimit për anëtarët e Komisionit të Konkurrencës;

Kryetarja – kërkoj nga Komisioni të miratohet lista prej 5 (pesë) anëtarëve për Komisionin e Konkurrencës.

Pas diskutimeve të gjëra, Komisioni uanimsisht miratoi listën prej 5 (pesë) anëtarve për Komisionin e Konkurrencës, dhe nxori këtë:

Rekomandim

Kuvendit të Kosovës që të miratoj këtë listë për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës, si më poshtë:

- 1.Halit Shabani;
- 2.Osman Ejupi;
- 3.Demir Jonuzi;
- 4.Gani Asllani dhe
- 5.Ahmet Krasniqi;

Gjithashtu kryetarja Selmani i'u bëri thirrje Grupit punues për përsheptimin e punëve për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, për hartimin e Raportit më Rekomandime, dhe Grupit punues për monitorimin e Ligjit pët Rrugët.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani